



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 830/5 Prot

Tiranë, më 20/9/2021

VENDIM

Nr. 45, datë 20.9.2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 5, 6 dhe 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës c), d) dhe e), të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale më përputhje me shkronjën e) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, sipas të cilës “Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kompetencë monitorimin e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit”, ka kryer monitorimin on-line të transparencës proaktive të Autoritetit Publik “Bashkia Elbasan” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në pikën 1, të nenit 4 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”) parashikohet se: “Autoriteti Publik vë në zbatim një program institucional transparence, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni”.

Në nenin 6 të LDI parashikohet se: “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi...”.

Nga monitorimi i kryer në faqen zyrtare <https://elbasani.gov.al/>, gjatë muajit nëntor 2020,

rezultoi se Autoriteti Publik nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 4, dhe nenit 6 të LDI, për të vendosur në zbatim programin institucional të transparencës sipas Urdhrit nr.211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë.

Konkretisht, nga monitorimi rezultoi se, Autoriteti Publik, nuk ka vendosur në zbatim Programin Model të Transparencës”, sipas modelit të miratuar nga Komisioneri: https://www.idp.al/wpcontent/uploads/2018/09/Programi_Model_i_Transparences_per_njesit_e_vetqeverisjes_vendore.pdf, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë.

Në përfundim të procesit të monitorimit, në muajin dhjetor 2020, Zyra e Komisionerit, miratoi Rekomandimin nr. 36, datë 23.12.2020 “Për programin e transparencës së Autoritetit Publik”. Në pikën 2 të Rekomandimit nr. 36 datë 23.12.2020, u parashikua afati prej 90 ditësh nga marrja dijani, për përmbushjen e detyrimit për pasqyrimin dhe ndërlidhjen e kategorive të informacionit të detyrueshëm për t`u bërë publik në programin e transparencës. Pas përfundimit të këtij afati, më datë 14.05.2021, Zyra e Komisionerit dërgoi pranë “Autoritetit Publik”, Urdhrit nr. 64 datë 14.05.2021 “Për kryerjen e hetimit administrativ”, protokolluar me tonën nr. 898 Prot., datë 14.05.2021.

Në përfundim të inspektimit, ndërmjet përfaqësuesve të Autoritetit Publik/Bashkisë Elbasan dhe Zyrës së Komisionerit u mbajt dhe procesverbali përkatës i inspektimit administrativ, nga i cili rezultoi se, Autoritet Publik/Bashkia Elbasan, nuk kishte plotësuar detyrimet e parashikuara në Rekomandimin nr. 36 datë 23.12.2020, me argumentimin që prej muajit janar 2021, faqja zyrtare e institucionit nuk kishte qenë funksionale. Nga ana e përfaqësuesve të Autoritetit Publik/Bashkia Elbasan u kërkua dhënia e një afati shtesë deri më datë 31.05.2021, për të mundur të gjitha përditësimet me informacionet e nevojshme të programit të transparencës.

Me përfundimin e afatit të kërkuar nga Autoriteti Publik/Bashkia Elbasan, Zyra e Komisionerit monitoroi sërish faqen zyrtare në internet, nga ku rezultoi se pavarësisht angazhimit dhe kërkesës për shtyrje të afatit, vijonte të mos kishte ndërmarrë asnjë masë në lidhje me vënien në zbatim të programit të transparencës. Me qëllim komunikimin e gjetjeve për Autoritetin Publik/Bashkinë Elbasan, me shkresën nr. 898/4 prot., datë 02.07.2021, Komisioneri njoftoi zhvillimin e një seance dëgjimore online (për shkak të gjëndjes së pandemisë COVID-19), më datë 7.07.2021. Autoriteti Publik/Bashkia Elbasan, me e-mailin datë 6.07.2021, kërkoi shtyrje të seancës dëgjimore më datë 14.07.2021, me argumentin se përfaqësuesit e tij ishin me leje vjetore, shtyrje e cila u pranua nga ana e Zyrës së Komisionerit.

Në datën 14.07.2021 u zhvillua seanca dëgjimore online, në prani të përfaqësuesve të Autoritetit Publik, Sekretares së Përgjithshme znj _____, në cilësinë e

personit përgjegjës për përbushjen e detyrimit për vënien në zbatim të programit institucional të transparencës, si dhe znj. me detyrën e koordinatores për të drejtën e informimit. Gjatë seancës dëgjimore, znj. Aulona Bylykbashi konfirmoi se Autoriteti Publik kishte marrë të gjitha masat dhe ishte në fazë finalizimi të publikimit të programit institucional të transparencës brenda ditëve në vijim. Në këto kushte, Zyra e Komisionerit, vlerësoi ndërgjegjësimin e treguar dhe masat e marra nga ana e Autoritetit Publik dhe informoi këtë të fundit mbi monitorimin e vazhdueshëm të faqes zyrtare të Bashkisë Elbasan, me qëllim verifikimin e përbushjes së detyrimeve ligjore.

Pavarësisht sa më sipër, ndryshe nga sa u deklarua në seancë dëgjimore, nga monitorimi i kryer nga ana e Zyrës së Komisionerit, deri në datën shpalljes së këtij vendimi, rezulton se Autoriteti Publik/Bashkia Elbasan, ka vendosur formalisht Programin e Transparencës së Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore, miratuar me Urdhrin nr.211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pa e ndërlidhur/pasuruar me informacionin përkatës, duke mos zbatuar detyrimin ligjor për vënien në zbatim të tij.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përbushur këtë të drejtë. Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore, si autoritete publike, mbartin gjithashtu detyrimin e garantimit të së drejtës për informim, si detyrim kushtetues dhe ligjor për të siguruar transparencën e veprimitarisë së tyre.

LDI promovon qasjen për dhënien e informacionit pa kërkesë përmes hartimit dhe miratimit të programit institucional të transparencës. Nëpërmjet Programit të Transparencës, i cili duhet publikohet në faqen zyrtare, njësitë të vetëqeverisjes vendore vendosin në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre, si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato.

Bazuar në nenin 6 të LDI, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Programin Model të Transparencës për Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore sipas urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 “Për Miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore”, i cili është i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha këto autoritete publike, duke filluar data 1 janar 2019.

Programi Model i Transparencës, është hartuar në përputhje me nenin 7 të LDI dhe i përshtatur në kontekstin e vetëqeverisjes vendore në përputhje dhe në zbatim të Kushtetutës, ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” si dhe të ligjit nr. 8548, datë 11.11.1999 Për Ratifikimin e “Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”.

Programi Model i Transparencës për Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore përfaqëson

instrumentin kryesor të transparencës në nivel vendor, që çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar ligjërisht ta zbatojë atë. Në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo Autoritet Publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të ligjit të sipërcituar.

Nga monitorimi i zhvilluar nga ana e Zyrës së Komisionerit dhe hetimi i thelluar më pas, në përputhje me nenin 41, 87 dhe 88 të Kodit të Procedurave Administrative, rezultoi se Autoriteti Publik nuk e ka përmbushur detyrimin e tij ligjor, si dhe nuk paraqiti asnjë argument apo provë për të arsyetuar mospërmbushjen dhe mos respektimin e dispozitave të LDI.

Pika 1 e nenit 18 të LDI, parashikon se: *“Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni”*.

Në pikën 2 të nenit 19 të LDI, parashikohet se: *“Në përputhje me parashikimet përkatëse të legjislacionit në fuqi që rregullon procedurën administrativë, titullari i autoritetit publik e delegon kompetencën e tij për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në pikën 1, të nenit 4, pikat 1 dhe 2, të nenit 5, pikat 1 dhe 2 të nenit 13, te nëpunësi më i lartë i autoritetit publik, sipas klasifikimit të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”. Në këtë rast nëpunësi mban përgjegjësi ligjore, për shkeljet administrative të parashikuara në shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “gj”, të pikës 2, të nenit 18, të këtij ligji.*

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi dhe hetimi administrativ i zhvilluar, Komisioneri vlerëson se është shkelur detyrimi për zbatimin dhe rishikimin e Programit Model të Transparencës të miratuar sipas Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, mosveprim që konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në përputhje me shkronjën “b”, pika 2 e nenit 18 të LDI.

Në vendosjen e sanksionit, nga ana e Komisionerit është mbajtur në konsideratë fakti se disa kategori të informacionit publik sipas kërkesave të nenit 7 pika 1 të LDI, gjenden të publikuara pjesërisht në faqen zyrtare të Autoritetit Publik.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 2 të nenit 19, të shkronjës, “b”, të pikës 2, të nenit 18, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën d) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Autoriteti Publik "Bashkia Elbasan", në zbatim të gërmave "a", "b" dhe "c", të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të vendosë në zbatim Programin Model të Transparencës, në përputhje me nenin 7 të ligjit si dhe sipas urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore" të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda datës 27. 9 .2021.
2. Dënimin e nëpunësit më të lartë të Autoritetit Publik, znj. _____, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Elbasan, në cilësinë e nëpunësit më të lartë civil, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me nenin 19, pika 2 e ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit".
3. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Bashkisë Elbasan brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikën 1, pala ka të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas nenit 18 të ligjit "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" të ndryshuar, si dhe nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 2, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ ka të drejtë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bëjë ankim në gjykatë sipas ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

Ky vendim u shpall sot në datë 20. 9 .2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi



Programi Transparencë për Bashkinë e Elbasanit

Home / Dokument

PROGRAMI TRANSPARENÇË PËR BASHKINË ELBASAN

I. HYRJE

Në përputhje me nenet 7 të Ligjit nr.14/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është deleguar programi i transparencës për Bashkinë Elbasan. Ky program përcakton formatin ligjor të veprimtarisë së zbatuarat, në kuadër të Ligjit nr.14/2014 "Për të Drejtën e Informimit" (L.D.).

Ky program veptron në mënyrë konkrete përshes në cilën Bashkia Elbasan ofron informacione dhe shërbime publike në mënyrë të hapur dhe të aksesueshme për qytetarët dhe të gjithë bashkësitë e Bashkisë së Elbasanit nëpërmjet Programit të Transparencës, në përputhje me parimin 2 të nenit 15 të L.D.-së.

Informacioni i të gjithë të këtyre programit, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së bashkisë, nëpërmjet pasqyrës së detajuar të tij të fazeve zotore me bashkësitë e qytetit dhe në mënyrë të hapur dhe të aksesueshme. Programi i transparencës pasqyrohet në strukturën, shkëlqimin dhe cilësinë e shërbimeve publike të bashkisë dhe të bashkësitë e bashkisë, në mënyrë të hapur dhe të aksesueshme, e cila prodhon dhe administrohet elektronikisht.

Në përputhje të programit të transparencës emendohet skema e publikimit, e cila pasqyrohet në adreset e dokumentit të fazeve zotore në internet, përmjet të cilave dokumentet janë aksesueshëm edhe në internet.

Dokumentacioni i të gjithë të këtyre programit, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së bashkisë, në mënyrë të hapur dhe të aksesueshme. Informacioni i të gjithë të këtyre programit, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së bashkisë, në mënyrë të hapur dhe të aksesueshme. Informacioni që karakterizohet nga kushtet e identifikimit të detyrës personale, për shkak të të cilave shërbimet së bashkisë ofrohen në mënyrë të hapur dhe të aksesueshme.

Skema e punës së bashkisë në internet, përmjet të cilave dokumentet janë aksesueshme në internet, të këtyre programit.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Për mënyrë të hapur dhe të aksesueshme Programi i Transparencës së AP Elbasanit:

1. "E drejta për informim" është e drejtë Kushtetuese e garantuar, arë në art.23 të Kushtetutit dhe në art.2 të Ligjit për aksesin në informim.
2. Presumimi i publikimit maksimal të të gjithë të këtyre bashkisë është funksionues, për të gjithë informacionin që rrethon të gjithë të këtyre bashkisë dhe të bashkësitë e bashkisë, në mënyrë të hapur dhe të aksesueshme.
3. Zbatimi i kësaj ligjeje dhe dispozitave tjera që rregullojnë në mënyrë të hapur veprimtarinë e AP-së dhe bashkisë është i gjallë.

